



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 331 Prot.

Vlorë, më 26/01/2024

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i sekuestros)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të një akti administrativ – Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore si vijon :

• Nr. 181 Prot., datë 16/01/2024, i materializuar për subjektin “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, me banim në Peshkëpi, Vllahinë.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit administrativ të lartcituar, i cili përbëhet prej 1 (një) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes së aktit të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 181 Prot.

Vlorë, më 16/01/2024

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori, subjekti “Egli Hoxhaj” p.f me ID J20908045I, me banim në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.103, me Nr.3599 Prot., datë 20/11/2023, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 230,275 (Dyqind e tridhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjet e pesë) lekë, për deklaratën doganore IM.4 me numër R 539, datë 18/01/2023, bazuar në nenin 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave, V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndaj subjektit debitor “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, me banim në Peshkëpi, Vllahinë, Selenicë.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.3599/1 Prot., datë 21/11/2023, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, ky vendim është njoftuar edhe me anë të lajmërimit publik, me shkresat si vijon : Shkresën Nr.3905 Prot., datë 14/12/2023 me lëndë “Kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore)” drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka konfirmuar kryerjen e shpalljes publike me nr.15786/1 Prot., datë 08/01/2024; me shkresën nr.3906 Prot., datë 14.12.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore)”, drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili ka konfirmuar kryerjen e shpalljes publike me nr.1067/1 Prot., datë 08/01/2024; me shkresën nr.3907 Prot., datë 14.12.2023 me lëndë “Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit i detyrimeve doganore)”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer shpalljen publike në websit-in e saj në kolonën “Njoftime” më datë 18/12/2023).

Personi fizik natyror “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.103, me Nr.3599 Prot., datë 20/11/2023, si dhe

nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.103, me Nr.3599 Prot., datë 20/11/2023, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, apo garantuesit/garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit fizik natyror - “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën, që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi fizik natyror - “Egli Hoxhaj” me NID. J20908045I, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 230,275 (Dyqind e tridhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjet e pesë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimit doganor Nr.103, me Nr.3599 Prot., datë 20/11/2023, të Degës së Doganës Vlorë, si dhe kamatë vonësën e lindur.

KRYETAR

Artan Bedinaj

